



REPUBLIKA E SHqipëRISE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 233, dt. 17.11.2015

Në mbështetje të nenit 29, pika 4, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 17. 11. 2015, pasi shqyrtoi propozimet për zonifikimet dhe rregulloret e Qendrave Historike të diskutuara më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e propozimit “Zonifikimi dhe Rregullorja e Administrimit të Qendrës Historike të qytetit Himarë-Fshat”.
2. Miratimin e propozimit “Zonifikimi dhe Rregullorja e Administrimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi”.
3. Miratimin e propozimit “Zonifikimi dhe Rregullorja e Administrimit të Qendrës Historike të fshatit Vuno”.
4. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI